

20 VENDE TË LIRA PËR PUNONJËS TË NIVELIT BAZË, NË FUNKSIONIN TRUP SHËRBIMI, NË GARDËN E REPUBLIKËS,

Kandidatët për punësim në Gardën e Republikës duhet të jenë ish punonjës të Gardës ose të strukturave të tjera me gradë (policia e shtetit, forcat e armatosura, policia e burgjeve etj).

I. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT :

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;
- ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- d) të jetë me gjatësi trupore jo më pak se 175 cm;
- dh) të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbim në struktura që, sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- ë) të mos jetë në ndjekje penale;
- f) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore;
- g) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Aplikanti që nuk plotëson qoftë edhe 1 nga kriteret e mësipërme, nuk kualifikohet dhe nuk duhet të vazhdojë aplikimin.

II. DOKUMENTAT QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT:

Aplikantët duhet të paraqesin në fazën e parë të konkurrimit dokumentet e mëposhtëm:

1. Kërkesë
2. CV (Kurikulum vitae)
3. Kopje të kartës së identitetit
4. Dëftesën e shkollës së mesme ose listë notash, **të cikluar** në Drejtorinë Arsimore të Rrethit, **të fotokopjuar dhe të noterizuar**.
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Raport i aftësisë në punë (sipas shtojcës V, të VKM nr.596, datë 4.9.2019), nga mjeku i familjes.
8. Dëshmi për kualifikimet e kryera (nëqoftëse ka)
9. Deklaratë personale mbi pastërtinë e figurës (Plotësohet kur aplikanti paraqitet për testim)
10. Vërtetim për vjetërsinë e shërbimit dhe motivacionin e largimit nga strukturat e tjera me gradë (policia e shtetit, forcat e armatosura, policia e burgjeve etj).
11. Dy foto (9 X 12) me këmbë dhe kollare.

Dokumentat do të dërgohen me postë në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Pallati i Brigadave, Tiranë, brenda datës 25.05.2023.

SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCESI I ANKIMIMIT

- Afati i shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit është 15 ditë pune nga mbyllja e afatit të aplikimeve.
- Aplikanti, që nuk plotëson kriteret dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit, skualifikohet.
- Aplikanti ka të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes. Komisioni i apelimit shqyrton dhe kthen përgjigje brenda 5 ditëve nga data e marrjes së ankesës me telefon ose adresë e-mail.

III. TESTIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët e kualifikuar në fazën e dorëzimit të dokumentave, duhet të paraqiten sipas njoftimit individualisht **në orën dhe datë që do ti komunikohet nga personeli**, në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Tiranë.

Kandidatët do t'i nënshtrohen intervistës dhe testit psikologjik

Aplikanti skualifikohet në rastet e mëposhtme:

- a) nuk paraqitet në kohën e caktuar për intervistë
- b) nuk kalon testin psikologjik;

IV. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët aplikues do të intervistohen nga një komision i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas rendit zbritës të pikëve.

V. KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË KONKURIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, të gjithë kandidatët fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (e-mail personal) ose me telefon nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Gardën e Republikës.